

Letër Pozicionimi për menaxhimin e burimeve ujore

1. Hyrje

Me anë të këtij dokumenti pozicionimi shoqëria civile i drejtohet institucioneve të mëposhtme:

- Institucioneve vendimarrëse (parlamentit, qeverisë qendrore dhe vendore),
- Këshillit Kombëtar të Ujrave dhe Bordeve të Administrimit të Ujrave,
- Institucioneve kërkimore-shkencore;
- Administruesve të Ujësjellës-Kanalizimeve,
- Përdoruesve të ujit,
- Medias

Kështu nuk mund të vazhdohet më! Uji është sfida e së ardhmes dhe ne duhet të punojmë për ta fituar këtë sfidë!

për të marrë përgjegjësitë për të përmirësuar menaxhimin e burimeve ujore.

Ndonëse legjislacioni për ujin po konsolidohet, njohja dhe zbatimi i tij veçanërisht nga pushteti vendor mbetet shqetësim.

Statistikat evropiane e vendosin Shqipërinë për sasinë e burimeve ujore dhe prurjet e tyre në vendet e para, ndërkohë që keqmenaxhimi i tyre ka krijuar prej kohësh probleme serioze për furnizimin me ujë të popullatës dhe ka shkaktuar ndotje të ujrave.

Ende mungon një vlerësim strategjik i plotë i kësaj pasurie kombëtare dhe një monitorim bashkëkohor i saj. Për më tepër, zhvillimet e sotme ekonomike dhe sociale në vend, që shpesh nuk shoqërohen me teknologjitë e përshtashme si p.sh. impiantet e pastrimit, ka bërë që ujrata të bëhen gjithnjë e më të ndotura nga veprimtaritë urbane, industriale dhe bujqësore.

Kultura e përdorimit të ujit dhe shkalla e ndërgjegjësimit të komunitetit mbetet ende mjaft e ulët. Shfrytëzimi i pakontrolluar i shtretërve të lumenjve është kthyer në një problem të mprehtë ekologjik.

Në takimin e Dhjetorit 2006¹ të OJF-ve mjedisore u identifikua si përparësi e sektorit kërkesa dhe mbështetja ndaj qeverisë vendore në përmbushjen e detyrimeve ligjore që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore (në ekspertizë dhe fonde). Uji bëhet edhe më i rëndësishëm po të marrim parasysh nevojat në rritje për konsum të tij të diktuar nga zhvillimi social-ekonomik i vendit. Në vijim të kësaj nisme OJF-të në takimin e 2008, mandatuan një grup pune të përbërë nga specialistë të fushës i cili luan rolin e sekretariatit

¹ Takimi i 6të kombëtar i shoqatave

të OJF-ve mjedisore. Ky sekretariat duke marrë në konsideratë dhe mendimin e OJFMve nëpërmjet këtij dokumenti ofron mendim alternativ për përmirësimin e menaxhimit të ujit duke shërbyer njëkohësisht si platformë veprimi për hartimin e fushatave.

Takimet e sekretariatit janë mbështetur nga Milieukontakt dhe në to janë shfrytëzuar informacionet mbi praktikat më të mira Evropiane të siguruara nëpërmjet kontakteve me rrjetet përkatëse të OJF-ve brenda dhe jashtë vendit.

2. Situata aktuale

Pellgu ujëmbledhës prej 44,000 km² dhe nivelet e larta të rreshjeve e bëjnë Shqipërinë një vend të pasur me rezerva hidrike në Europë. Por, ndryshimet klimatike botërore pritet të përkeqësojnë treguesit e burimeve ujore edhe në vendin tonë. Kështu, rezervat ujore të shfrytëzueshme në dekadën e ardhshme parashikohet të zvogelohen. Vrojtimet e viteve të fundit tregojnë një rënie të nivelit të rreshjeve në Shqipëri në masën 5-15% dhe një shpërndarje kohore vjetore të ndryshuar. Njëherazi, evidentohet që një pjesë e konsiderueshme (20-25%) e ujit në rezervuare e destinuar për prodhim energjie, po infiltron në basenet e ujrave nëntokësore.

Rritja e nevojave për ujë nuk është e njëjtë në të gjithë territorin. Zhvillimet demografike dhe përqëndrimi i popullsisë drejt qendrave të mëdha urbane është shoqëruar me rritje të nevojës për përdorim të ujit në këto zona dhe pamjaftueshmërisë për t'ju përgjigjur kësaj kërkesë. Për më tepër në këto hapësira është rritur shkalla e ndotjes së ujit. Sasia dhe cilësia e ujit mbetet një problem themelor dhe me pasoja direkte në shëndetin e popullatës. Infrastruktura e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve lë për të dëshiruar, veçanërisht në zonat rurale. Investimet e deritanishme nuk i përgjigjen kërkesave në rritje për furnizim me ujë të popullatës. Një pjesë e këtyre investimeve janë jo efektive për shkak të mungesës së bashkërendimit të tyre.

Shoqëria shqiptare ka një sjellje jo miqësore ndaj përdorimit të ujit. Sasi të mëdha uji shpërdorohen, ndërhyrjet në rrjet janë dukuri e zakonshme dhe tarracat e pallateve në qytete janë mbushur me depozita uji. Kultura e përdorimit të ujit është koncept, dije, dhe arrihet duke përfshirë dhe zbatuar paralelisht një sërë faktorësh në shtresa dhe mosha të ndryshme të shoqërisë. Procesi kërkon kohë, është i vështirë dhe i mundimshëm prandaj nevojitet edukim. Për të plotësuar nevojat me ujë të popullatës nuk mjaftojnë vetëm teknologjitë dhe investimet. Burimet ujore janë pasuri natyrore kombëtare, por ato shpesh nuk vlerësohen si të tilla. Mungon një rrjet i përshtatshëm montorimi i gjendjes dhe cilësisë së tyre. Mbështetja me specialistë, fonde dhe bazën e nevojshme teknike për institucionet kërkimore-shkencore, që mbulojnë këto tematika është në nivele të pamjaftueshme. Ka një amulli në lidhje me administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve ujore, që ul në mënyrë të dukshme efektivitetin e përdorimit të tyre. Vërehet një degradim i dukshëm i sistemit të ujitjes dhe kullimit të tokave që shoqërohet në mënyrë të përvitshme me përmytje të sipërfaqeve të mëdha. Mungon

mirëmbajtja e sistemeve të digave të vogla dhe pritave të përrrenjve malorë, mosfunksionimi i të cilave shkakton një shkallë të lartë erozioni të tokave si në shpatet e maleve dhe kodrave, ashtu dhe në fushë.

3. Analiza e situates

Ndonëse Shqipëria është një vend i pasur me ujra nëntokësore dhe sipërfaqësore, në analizën që bëhet kur diskutohet treguesi i rrezikut të zhvillimit njerezor (Human Development Risk Indeks), ajo kategorizohet si një vend me risk të mesëm në lidhje furnizimin me ujë në zonat urbane dhe me risk të lartë në zonat rurale. Faktorët që ndikojnë në këtë situatë janë:

- Orientimi i investimeve drejt shtesës së ujit në qendrat e banuara dhe jo drejt shpërndarjes dhe monitorimit të rregullt të ujit për të gjitha zonat e banuara.
- Çoroditja e sistemeve hidraulike në qytete si pasojë e instalimeve të rezervuarëve familjarë dhe pompave individualë që thithin ujë direkt nga linjat e ujësjellësit.
- Mungesa e ndërgjegjësimit të përdoruesve për mirëpërdorimin e ujit.
- Moskonsiderimi i ujit nga qytetarët si një pasuri e rëndësishme kombëtare.
- Pamjaftueshmëria dhe papërshtatshmëria e sistemeve monitoruese të ujrave.

Këtyre faktorëve u shtohen mungesa e shërbimit korrekt nga ana e punonjësve të ujësjellësave dhe mungesat e theksuara në legjislacion apo në zbatimin rigoroz të legjislacionit në fuqi.

Përpyekjet e deritanishme të bëra nga pushteti qëndror si p.sh. decentralizimi i ujësjellësave tek pushteti vendor, nuk kanë sjellë ndonjë ndryshim në lidhje me përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Ujësjellësat janë sisteme komplekse që kërkojnë aftësimin e punonjësve, paisjen e sistemeve me aparatura kontrolli dhe komandimi si dhe një mbështetje të përshtatshme legjislative.

Sot nuk ka një bazë të dhënash për ujrën, e cila të përditësohet në mënyrë periodike.

Vlerësimi i gjendjes së burimeve ujore është i pjesshëm, kurse monitorimi i tyre nuk funksionon. Përdorimi racional i fondeve për problemin e ujit është ende larg plotësimit të nevojave të mësipërme dhe kërkon detyrimisht pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile për të ushtruar presionin e duhur ndaj organeve përgjegjëse. Kultura e përdorimit të ujit nga bizneset e ndryshme është larg të qenit miqësore me mjedisin. Shumë biznese përdorin ujin e pijshëm për ujitje ose lavazhe, ndërsa uji në shtëpitë e konsumatorëve nuk ekonomizohet sipas kërkesave apo synimeve të një jetese në harmoni me mjedisin. Administrimi i ujrave dhe veçanërisht përmirësimi i furnizimit me ujë të banorëve duhet të kryhet nëpërmjet programeve të integruara ligjore, ekonomike, sociale dhe teknike.

4. Rekomandime

Për të përmbushur nevojat për ujë të banorëve, bizneseve, aktiviteteve bujqësore dhe industriale, turizmit si dhe për të përmirësuar standardet ekologjike dhe kapacitetet natyrore mbajtëse, ne anëtarë të shoqërisë civile propozojmë rekomandimet e mëposhtme:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e ujrave dhe zbatimin e tij rigoroz.

Krahas përmirësimeve të bëra në kuadrin ligjor të ujrave, situata e re kërkon rishikim të këtij legjislacioni, përafrimin e tij me atë evropian dhe zbatimin e tij.

- Akte të veçanta nënligjore duhet të përcaktojnë indeksin e prurjes më të ulët ekologjike në lumenj.
- Rishikim shkencor i vlefshmërisë dhe i përputhshmërisë së akteve ligjore ndërshtetërore për menaxhimin e ujrave shqiptare në përputhje me konventat ndërkombëtare.
- Proceset e reformave në fushën e ujit kërkojnë kontribut aktiv të publikut. Për këtë arsye është thelbësore që ai të përfshihet në të gjitha fazat, ndaj vendimarrja në nivel qendror dhe vendor duhet detyrimisht të paraprihet nga informimi dhe pjesëmarrja publike.
- Forcimi i kapaciteteve lokale me përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.
- Forcimi dhe përmirësimi i teknologjisë së sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të ujrave sipas standarteve të Direktives Kuadër të Ujit (WFD) dhe Organizatës Botërore të Meteorologjisë (WMO).
- Detyrimi me ligj i vendosjes së impianteve të trajtimit të ujrave të përdorura dhe veçanërisht nxitja e investimeve në infrastrukturën për përpunimin e ujrave industriale.
- Përmirësimi i aftësive profesionale e teknike të operatorëve të shpërndarjes dhe menaxhimit të ujit.
- Promovimi i praktikave dhe teknologjive të integruara të përdorimit të ujit.
- Përfshirja e tematikës së ujit në kurrikulat shkollore. Edukimi i brezit të ri me koncepte dhe sjellje të reja ndaj ujit duhet të gjejnë pasqyrim në kurrikulat shkollore, krahas masave të gjithanshme për rritjen e kulturës së përdorimit të ujit.
- Rritja e ndjeshmërisë së medias ndaj trajtimit të çështjes së ujit. Roli i medias, si në të gjitha fushat, edhe në atë të ujrave, është tepër i lartë si në drejtim të sensibilizimit ashtu dhe evedentimit të mangësive dhe përmirësimit të tyre.
- Shtimi dhe përdorimi racional i fondeve për administrimin, ruajtjen dhe përdorimin e ujrave.